



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr.11, datë 03.10.2018

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

**“NDËRTIMI I BURIMIT RIGJENERUES TË ENERGJISË, HIDROCENTRALIT
“TËRFOJA”, NË PELLGUN UJËMBLEDHËS TË PËRROIT TË FSHATIT DHE
PËRROIT TË MADH, DEGË TË LUMIT BUSHTRICË”, BASHKIA KUKËS**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Hec Tërfoja” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i burimit rigjenerues të energjisë, Hidrocentralit “Tërfoja”, në pellgun ujëmbledhës të përroit të fshatit dhe përroit të madh, degë të lumit bushtricë”, Bashkia Kukës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Hec Tërfoja” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Kukës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

Belinda Balluku
BELINDA BALLUKU



MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

[Signature]
ANËTAR / SEKRETAR I KKT

LEDIA TOFA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

